



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

---

Numri i lëndës: 2024:165644

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05838737

PPP.nr.18/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, e përbërë nga gjykatësi i vetëm Avni Berisha, në lëndën përmbarese të kreditores H.Th nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson i autorizuari Av. Z.H nga Prishtina, kundër debitori Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, të cilën e përfaqëson i autorizuari av.B.O, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër urdhërit të përmbaresit privat B.B P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024, më 20.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, ashtu që SHFUQIZOHET urdhëri të përmbaresit privat B.B nga Peja, P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024, sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të kreditorëve që në emër të shpenzimeve për për përpilimin e propozimit për përmbarim të paguaj shumën prej 28,08 euro në emër të TVSH-18%.
- II. MBETET NË FUQI urdhri i përmbaresit privat B.B, nga Peja P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024, me të cilin është caktuar përmbarimi e borxhit për shkak të detyrimit në të holla në emër të shpërblimit jubilar kreditores H.Th nga Rahoveci, ti paguaj shumën prej 3,301.74 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë 20.08.2020, si dhe në po të njëjtin afat ti paguaj edhe shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 2,346.00 euro, me kamatë prej 8 %, nga dita e paraqitjes së propozimit me datë 23.04.2024, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore për përpilimin e propozimit të paguaj shumën prej 156.00 euro.
- III. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë, konform nenit 78 të LPP-së.

## A r s y e t i m

Në bazë të propozimit të kreditores H.Th nga Rahoveci, përmbaruesi privat B.B nga Peja, ka lejuar përmbarimin sipas urdhrin P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024, në bazë të dokumentit përmbarimor, Aktgjykimit C.nr.356/20, i datës 24.01.2022, i plotfuqishëm me datë 28.02.2024, i ekzekutueshëm nga data 03.04.2024, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, për shkak të detyrimit në të holla në emër të shpërblimit jubilar, në shumën e përgjithshme prej 5,831.82 euro.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përmbarim, debitori Komuna e Rahovecit, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për caktimin e përmbarimit, pasi që sipas tij, propozimi përmban kërkesë e cila është e pa lejuar sepse propozimi për përmbarim është bërë në bazë të titullit ekzekutiv-Aktgjykimit C.nr.356/2020 në të cilin aktgjykim janë për përfshirë 7 paditës ndërsa propozimi për përmbarim është bërë për secilin paditës ndaras dhe ka kërkuar që përfaqësuesit të autorizuar të kreditorëve të mos i njihen shpenzimet procedurale. Po ashtu ka deklaruar se kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.1637/2022 të datës 28.02.2024, në këtë qështje kontestimore ka paraqitur Revizion.

Kreditorja brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazë, me arsyetimin se kundërshtimi i debitorit nuk mbështetë në asnjërin nga arsyet me dispozitën 71 të LPP-së. Duke shtuar se dokumenti përmbarues sipas të cilit është caktuar përmbarimin, nuk është prishur, anuluar, ndryshuar apo shfuqizuar, respektivisht i njëjti është i përshtatshme për përmbarim. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditores, urdhërit për lejimin e përmbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditores, shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.3 të dt.31.01.2013, më tej LPP) në nenin 21 përcaktohen bazat juridike për caktimin e përmbarimit, *"Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër"*, ndërsa me nenin 22 par.1 nënpar.1.1 përcaktohet se *"1. Dokumente përmbaruese janë: 1.1"vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese"*.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024, sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të kreditorëve që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbarim të paguaj shumën prej 28,08 euro në emër të TVSH-18%., me arsyetimin se këto shpenzime nuk i përkasin dispozitivit të vendimit gjyqësor i cili kërkohet që të përmbarohet e as nuk janë të parapara në Tarifën e Odës së Avokatëve.

Gjykata me analizimin dhe shikimin e dokumenti përmbarues – Aktgjykimi C.nr.356/20, i datës 24.01.2022, vërtetoi faktin se debitori ka qenë i obliguar për shkak të detyrimit në të holla në emër të pagave jubilarë kreditores, t'ia paguaj shumë e përgjithshme prej 3,301.74 euro, të gjitha

me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 2,346.00 euro në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim. Debitori me asnjë prove nuk arriti të vërtetojë faktin se ka kryer pagesën për këtë shumë. Gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se dokumenti përmbartimor – Aktgjykimit C.nr.356/20, i datës 24.01.2022, i dhënë në procedurë gjyqësore është nxjerrë nga organi kompetent, ka marrë formën e prerë me datë 28.02.2024, si dhe i njëjti është i ekzekutueshëm nga data 03.04.2024. Sipas LPP-së nenit 27 par.1 përcaktohet se *”Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përmbartimor për shkak se e ka të përcaktuar kreditoren dhe debitorin, kohën e përmbushjes së detyrimit, si dhe shumën e përmbushjes, andaj si i tillë është i përshtatshëm për përmbartim, andaj edhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi urdhërin përmbartimor P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024.

Gjykata analizoi kundërshtimet e debitorit lidhur me urdhërit për lejimin e përmbartimit P.nr.3418/24, të datës 23.04.2024, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të pabazuar, sepse gjykata në procedurën përmbartimore nuk lëshohet në ligjshmërinë materiale të dokumentit përmbartues, në bazë të të cilit kërkohet përmbartimi. Gjykata në procedurën përmbartimore kujdeset se a është bërë propozimi për përmbartim dhe a është lejuar përmbartimi në bazë të dokumentit përmbartues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi. Në rastin konkret përmbartimi është lejuar në bazë dokumenti përmbartimor Aktgjykim, C.nr.356/20, i datës 24.01.2022, të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec, i plotfuqishëm me datë 28.02.2024, i ekzekutueshëm nga data 03.04.2024, ndërsa kreditorët propozimin për përmbartim e kanë parashtruar me datë 06.12.2022, brenda afatit sipas të cilit mund kërkohet përmbartimi.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22, 23, 24 par.1 dhe 27 lidhur me nenin 73, 77 par.1 dhe 5 dhe nenit 290 të Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË -DEGA NË RAHOVEC  
PPP.nr.18/2024, dt. 20.06.2024

Gj y q t a r i  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.